



Pranimi / Dorezuar Prilijeno/Prodato Received/Delivery	26.05.2021	1	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojt e Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/SH/OK	2656/2021		1/4



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.333/2021

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga:** Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi dhe Arben Mehmeti-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.2871/2019 të datës 16.04.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.175/2019 të datës 07.03.2019 të parashtruar nga ankuesi me adresë rruga "UÇK", B-1, kati IV, Nr,12 në Prishtinë, kundër organit të punësimit-Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në çështjen juridike "Kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 26.05.2021, mori këtë:

### V E N D I M

**Refuzohet si e pabazuar** ankesa me numër A.nr.175/2019 e datës 07.03.2019 e parashtruar nga ankuesi e shqyrtuar sipas Aktgjykimit A.nr.2871/2019 të datës 16.04.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

### A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në pozitën "Përkthyes i gjuhës angleze" sipas Akt Emërimit të datës 29.09.2011 në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, më datë 10.12.2018 ka parashtruar kërkesë për rritje të koeficientit nga shtatë (7) në tetë (8) tek Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ndërsa më datë 30.01.2019 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit.

Ankuesi, kudër heshtjes administrative të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, më datë 07.03.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 1210/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Më datë 19.03.2019 Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për marrjen e vendimit meritor administroj këto prova:** Ankesën me numër protokolli 1210/2019 të datës 07.03.2019 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për avancim rritje të koeficientit e datës 10.12.2018 e ankuesit për Sekretarin e Përgjithshëm të MASHT; E-mailin e datës 05.03.2019 të ankuesit; Ankesën e datës 30.01.2019 të parashtruar nga ankuesi në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Katalogun e vendeve të punës; Akt Emërimit e datës 29.09.2011 të ankuesit; Klasifikimin e vendeve të punës i datës 21.07.2016 për Sekretarin e Përgjithshëm të MAP; Procedimin në sistem të pagave i datës 23.11.2017; Kërkesën për nivelizim të koeficienteve në bazë të rregullores për shërbyes civil e datës 06.07.2017; Kërkesë për miratim datës 12.06.2017; Procesverbalin e datës 22.05.2017 dhe 30.05.2017; Vendimin me numër 2-1853 i datës 17.05.2017 dhe Përgjigjen në ankesë e datës 19.03.2019 me numër protokolli 1471/2019; Aktgjykimin A.nr.2871/2019 të datës 16.04.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Kërkesën për informata e datës 16.02.2021 për ankuesin; Njoftimin e datës 16.02.2021 të ankuesit dhe Përgjigjen lidhur me ankesën e datës 23.04.2019, si dhe provën shtesë të datës 21.05.2021 me nr.prot 2537.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesit

**është e pabazuar, sepse:**

Ankuesit në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon për ngritjen e koeficientit nga shtatë (7) në tetë (8).

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit, ka konstatuar se ankuesi themelimin e marrëdhënies së punës në pozitën e lartcekur e ka bërë me koeficient shtatë (7), po ashtu në bazë të ndryshimit dhe plotësimit të Aktit Emërimit për pozitën e ankuesit nuk është paraparë ndryshim i koeficientit, ndërsa në bazë të përshkrimit të detyrave të punës për këtë pozitë konstatohet që për këtë pozite kërkohet *"diplomë universitare në drejtme shoqërore, 2 vite përvoje pune"*, po ashtu koeficienti shtatë (7) është paraparë edhe në konkursin e shpallur më datë 14 korrik 2010. Bazuar në këtë por edhe në bazë të provave të lëndës, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjie më datë 17.05.20217 ka nxjerr Vendim me numër 2-1853 me të cilin ka formuar Komisionin për Harmonizimin e Koeficientëve,

ndërsa si rezultat i kësaj është kërkuar nga Ministria e Administratës Publike të bëhet nivelizimi i koeficienteve për pozita të ndryshme brenda Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, mirëpo Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil i Ministrisë së Administratës Publike më datë 23.11.2017 përmes shkresës me numër reference DASHC/MAP-04/530, ka analizuar propozimet e MASHT për nivelizim të koeficientëve duke bashkangjitur listën e pozitave që do të kenë nivelizim të koeficientëve, mirëpo në bazë të kësaj liste pozita që mban ankuesi nuk përfshihet në këtë rast, po ashtu në këtë shkresë përcaktohet që: *“Për ndryshimet e bëra MASHT duhet të siguron buxhet për realizimin e tyre në sitëm të pagave”*.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, vlerëson se tek rasti i ankuesit nuk kemi asnjë akt administrativ nga Zyrtar më i Lartë Administrativ i ministrisë me të cilën i është ngritur koeficienti, po ashtu nuk është dëshmuar me asnjë provë që ministria ka buxhet të mjaftueshëm për realizimin e ngritjes së koeficientit, kështu që edhe pse nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka propozuar që pozita e ankuesit të jetë “Zyrtar i Lartë për Përkthime”, nuk ka asnjë dëshmi që kjo të ketë pasur miratim nga ministria përgjegjëse për administratë publike.


Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se neni 7 paragrafi 1 dhe 1 i Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil i cili përcakton: *“Udhëheqësit e institucioneve të administratës publike ia propozojnë gradat e pozitave në institucionin e tyre ministrisë përgjegjëse për administratë publike, në bazë të rekomandimeve të personit përgjegjës për burime njerëzore në institucionin e tyre, i cili është përgjegjës për zbatimin e standardeve dhe procedurave për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil. 2. Grada për secilin pozicion të punës dhe ndryshimet, miratohen nga Qeveria, me propozim të institucionit përkatës dhe aprovimit paraprak të ministrisë përgjegjëse për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për financat”*, rrjedhimisht Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se ligjërisht ngritja e koeficientëve për nëpunësit civil, mund të bëhet vetëm nëpërmjet procedurave ligjore e që duhet dëshmohet se institucioni ka planifikuar mjete buxhetore të miratuara nga ministria përgjegjëse për administratë publike respektivisht ministria përgjegjëse për financa, kështu përderisa nuk ka planifikim buxhetit apo nuk ka kërkesë nga institucioni ku nëpunësi civil është duke e ushtruar pozitën tek institucionet gjegjëse, atëherë përderisa nuk plotësohen kushtet e tilla ligjore nëpunësi civil paguhet me pagë siç është përcaktuar në aktin e emërimit me të cilin ka themeluar marrëdhënien e tij të punës, siç parashihet me Ligjin Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, respektivisht nenin 9 paragrafin 1 përcakton se: *“Nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin pagën bazë për numrin e orëve të përcaktuara në aktin e kontratës së punës”*.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Aktgjykimin A.nr.2871/2019 të datës 16.04.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.333/2021

**Avdyl BEKTESHI**  
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



**Eshref SHABANI**  
Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit,
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.

